

OPERIMI I PUSEVE

Përshkrimi i kursit

Në Shqipëri, pjesa më e madhe e zonave urbane dhe të gjitha zonat rurale përdorin ujrat nëntokësor si burim kryesor për të siguruar furnizim me ujë të pijshëm. Prandaj ruajtja dhe mbrojtja e këtyre burimeve dhe zbatimi i praktikave për parandalimin e ndotjeve të mundshme është një domosdoshmëri. Shoqëritë UK duhet të zbatojnë kërkesat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me vendndodhjen e puseve në lidhje me rreziqet sanitare. Punonjësit duhet të operojnë dhe mirëmbajnë puset në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme.



Ky kurs trajnimi ofron njohuri mbi instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve përbërëse të pusit. Gjithashtu, testimi i performancës së puseve dhe llojet e testeve të pompimit do të trajtohen dhe diskutohen gjatë trajnimit.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinieret e prodhimit dhe inxhinierët e projektimit.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikoni disa nga burimet e mundshme të ndotjes së ujrave nëntokësor;

- Njihni legjislacionin lidhur me mbrojtjen e puseve;
- Përcaktoni faktorët që duhet të merren parasysh ndërsa përcaktohet zona për ndërtimin e pusit;
- Identifikoni llojet e puseve;
- Identifikoni dhe njihni funksionin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse të një pusit;
- Identifikoni faktorët që ndikojnë në mirëmbajtjen e një pusit;
- Njihni procedurat për mbylljen e një pusit;
- Identifikoni dhe njihni problemet që shkaktohen nga rëra;
- Identifikoni metodat për zvogëlimin e prodhimit të rërës;
- Aplikoni procedurat e kontrollit të operimit të pompave;
- Shpjegoni rëndësinë e projektimit dhe instalimit në mënyrën e duhur të komponentëve të pusit;
- Identifikoni llojet e analizave për puse specifike.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Operimin i Puseve". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person
Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.